



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E APELIT SHKODËR

Nr. Regj.Them.162/1569 (00150)

Datë 07.03.2014

Nr.Vendimi 258

Datë 27.04.2015

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Trupi gjykues i Gjykatës së Apelit Shkodër i përbërë nga gjyqtarët:

Kryesues
Anëtare
Anëtare

Selim KRYEZIU
Lindita HOXHA
Valbona VATA

me sekretare seance Virtuoza Tuzi, më datë 27.04.2015. në seancë gjyqësore publike, mori në shqyrtim ankimin për çështjen civile, që i përket palëve ndërgjyqëse:

KËRKUESE:

Syri Dervishi, i biri i Nuro dhe Fetije, i dt.lindjes 01.12.1949, lindur dhe banues në Shkodër. Lagje “N.Gjylbegu”, Rruga “B.Bishanaku”, i martuar, në mungesë.

PERSONA TË TRETË:

1.Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër, përfaqëzuar me autorizim nr.4085 prot., datë 27.04.2015 nga juristja Sirjana Bakushi, prezente.

2.Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë, në mungesë.

OBJEKTI:

Saktësimin e emrit nga Syrri në Syri, në dokumentin zyrtar të regjistrimit të biznesit si person fizik Syri Dervishi pranë Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër dhe të sigurimeve shoqërore për efekt të vjetërsisë në punë.

BAZA LIGJORE:

Neni 388 i K.Pr.Civile.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin Nr.118 (300), datë 28.01.2014 ka vendosur:

1.Pranimin e kërkesës së kërkuarit Syri Nuro Dervishi, duke saktësuar emrin në dokumentin zyrtar të regjistrimit të biznesit si person fizik pranë Drejtorisë Rajonale e

Tatimeve Shkodër dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë nga ai i shënuar gabim "Syri" në atë të saktë "Syri".

2. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 15 ditëve në Gjykatën e Apelit Shkodër.....

Kundër këtij vendimi, më datë 11.02.2014, ka paraqitur ankim personi i tretë Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër, duke parashtruar këto shkaqe për ankimin:

- Në seancën gjyqësore të datës 13.01.2014 nga pala kërkuuese u kërkuar të thirrej në cilësinë e personit të tretë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë, kërkesë e cila nuk u bë në formën e kërkuar nga ligji, në zbatim të nenit 192 të K.Pr.Civile duke vlerësuar dhe komunikimin e saj palëve në gjykim, kërkesë e cila duhej të kishte të mirëpritur bazën ligjore të saj.
- Vendimi është i padrejtë, i pabazuar në ligj.
- Pala kërkuuese nuk mund t'i drejtohej gjykatës me këtë kërkesë, dhe me bazë ligjore të kërimit të tij nenin 388 të K.Pr.Civile.
- Pala kërkuuese argumentonte se i është drejtuar Qendrës Kombëtare të Regjistrimit duke kërkuar saktësimin e pretenduar, por në vijim i drejtohet gjykatës bazuar në nenin 388 të K.Pr.Civile.
- Në zbatim të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar neni 43 dhe ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" neni 23 pika 2 dhe neni 65 pika 2, saktësimi i të dhënave realizohet vetëm nga Q.K.R.
- Pala kërkuuese nuk disponoi për të thirrur si palë Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, për të sqaruar dhe mënyrën e administrimit të të dhënave të marra apo deklaruar pranë saj nga subjekti.
- Pala kërkuuese nuk paraqiti asnjë kërkesë formale adresuar organit tatimor në lidhje me pretendimin e tij.
- Gjykata ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, pasi nuk e shtyu seancën për të përgaritur konkluzionet përfundimtare.

Prandaj, në përfundim të ankimit personi i tretë Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër ka kërkuar:

"Ndryshimin e vendimi nr.118 (300), datë 28.01.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe rrëzimin e kësaj kërkesë".

GJYKATA E APELIT SHKODËR,

pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit Selim Kryeziu; dëgjoi përfaqësuesen e personit të tretë, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër, e cila kërkoj sipas ankimit, ose prishjen e vendimit dhe pushimin e gjykimit të çështjes; shqyrtoi çështjen në mungesë të kërkuarit dhe personit të tretë Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë, të cilët megjithëse janë njoftuar rregullisht me shpallje nuk janë paraqitur, pa parashtruar shkaqe të arsyeshme; si edhe pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi;

VËREN

Vendimi nr.118 (300), datë 28.01.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është marrë në interpretim dhe zbatim të gabuar ligjit procedural dhe atij material civil, në një analizë joligjore të provave të paraqitura nga palët në proces, dhe si i tillë ai duhet të priset duke vendosur pushimin e gjykimit të çështjes.

Nga gjykimi i çështjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe provat e marra në atë gjykim rezultojn se:

Kërkuesi Syri Dervishi, më datë 23.10.2013, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe ka kërkuar: *"Saktësimin e emrit nga Syrri në Syri, në dokumentin zyrtar të regjistrimit të biznesit si person fizik Syri Dervishi pranë Drejtorisë Rajonale e Tatimeve Shkodër dhe të sigurimeve shoqërore për efekt të vjetërsisë në punë"*. bazuar në nenin 388 të K.Pr.Civile.

Kërkuesi Syri Dervishi ka pretenduar se ushtron një aktivitet privat si subjekt privat, por emri si subjekt është regjistruar gabim nga Syri Dervishi që është i saktë, në Syrri Dervishi që është i gabuar, dhe kjo gjë atij i sjell pasoja.

Për të provuar pretendimet e tij kërkuesi Syri Dervishi ka paraqitur ekstraktin historik të regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit "Person Fizik", të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit **më datë 27.05.2013**, ku emri i subjektit rezultojn **Syrri Dervishi**.

Gjithashtu, nga vërtetimi i korrigjimit të gabimeve të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit **më datë 05.12.2013**, rezultojn se është kryer korrigjimi i emrit të subjektit nga Syrri në Syri.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, mbi bazën e këtyre provave, me vendimin nr.118 (300), datë 28.01.2014 ka vendosur:

- 1.Pranimin e kërkesës së kërkuesit Syri Nuro Dervishi, duke saktësuar emrin në dokumentin zyrtar të regjistrimit të biznesit si person fizik pranë Drejtorisë Rajonale e Tatimeve Shkodër dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë nga ai i shënuar gabim "Syrri" në atë të saktë "Syri".
- 2.Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
- 3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 15 ditëve në Gjykatën e Apelit Shkodër....

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim personi i tretë Drejtorisë Rajonale e Tatimeve Shkodër, duke parashtruar shkaqet e relatuar në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

Duke marrë në analizë shkaqet e ankimit, pretendimet përpara kësaj gjykate, përsëritjen e pjesësme të hetimit gjyqësor, konform nenit 465/2 të K.Pr.Civile, si dhe duke e shqyrtuar çështjen në tërësi, Gjykata e apelit çmon se vendimi nr.118 (300), datë 28.01.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është marrë në interpretim dhe zbatim të gabuar ligjit procedural dhe atij material civil, në një analizë joligjore të provave të paraqitura nga palët në proces, dhe si i tillë ai duhet të priset duke vendosur pushimin e gjykimit të çështjes.

Gjykata e apelit çmon se vendimi nr.118 (300), datë 28.01.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nuk është marrë në përputhje me nenin 388 të K.Pr.Civile, në të cilin përcaktohet se:

"Kur nga një fakt varet lindja, ndryshimi ose shuarja e të drejtave personale apo pasurore të një personi dhe akti që vërteton atë është zhdukur, ka humbur dhe nuk mund të bëhet përsëri ose nuk mund të merret me ndonjë rrugë tjetër, personi i interesuar ka të drejtë të kërkojë që fakti të vërtetohet me vendim të gjykatës së shkallës së parë.

Kërkesa për vërtetimin e fakteve paraqitet në gjykatën e shkallës së parë, në territorin e së cilës ka banimin Kërkuesja. Kur kërkohet vërtetimi i faktit për një send të paluajtshëm, ajo paraqitet në gjykatën e shkallës së parë në territorin e së cilës ndodhet sendi.

Në mënyrën e treguar më sipër mund të kërkohet edhe korrigjimi i gabimeve të akteve të treguara në paragrafin e parë të këtij neni".

Po kështu, sipas nenit 389 të K.Pr.Civile në kërkesën për vërtetimin e fakteve juridike, apo korrigjimin e gabimeve të bëra, duhet të tregohen qëllimi për të cilin kërkuesi paraqet kërkesën për vërtetimin e faktit të caktuar, apo korrigjimin e gabimeve, shkaqet për të cilat nuk mund të merret akti ose për të cilat nuk është e mundur që akti të bëhet përsëri, provat me të cilat do të provohet, si shkak i mungesës, ashtu edhe fakti që kërkohet të provohet.

Në referim të dispozitave të mësipërme, Gjykata e Apelit çmon se vendimi nr.118 (300), datë 28.01.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është i cënueshëm për shkaqet e mëposhtme:

Në lidhje me pretendimin e kërkuesit për saktësimin e emrit nga Syrri në Syri, në dokumentin zyrtar të regjistrimit të biznesit si person fizik Syri Dervishi pranë Drejtorisë Rajonale e Tatimeve Shkodër dhe të sigurimeve shoqërore për efekt të vjetërsisë në punë, Gjykata e apelit çmon se këto pretendime nuk janë ligjore, prandaj vendimi nr.118 (300), datë 28.01.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, duhet prishur duke u vendosur pushimi i gjykimit të çështjes.

Gjykata e apelit arrin në këtë konkluzion duke u mbështetur në provat e marra dhe të shqyrtuara nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Konkretisht, nga vërtetimi i korrigjimit të gabimeve të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit **më datë 05.12.2013**, rezulton se është kryer korrigjimi i emrit të subjektit nga Syrri në Syri (shih faqe 12 të dosjes gjyqësore), ndërsa në lidhje me atë të sigurimeve shoqërore kërkuesi nuk e ka kërkuar gjatë gjykimit duke hequr dorë nga kjo pjesë, si dhe duke mos bërë ankim kundër vendimit.

Në rastin konkret, kërkuesi Syri Dervishi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe ka kërkuar saktësimin e emrit nga Syrri në Syri, duke iu referuar nenit 388 të K.Pr.Civile, por në gjykim ka rezultuar se ky korrigjim ka qenë kryer nga organi përkatës, Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

Gjithashtu, në përsëritjen e pjesshme të hetimit gjyqësor, konform nenit 465/2 të K.Pr.Civile, dhe me provat e marra në këtë gjykim, rezultoi e provuar se subjekti Syri Dervishi tashmë rezulton i çregjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, fakt i cili provohet me certifikatën e çregjistrimit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit më datë 03.04.2015.

Si rrjedhim, bazuar në nenin 468 të K.Pr.Civile. Gjykata e Apelit arrin në konkluzionin se vendimi nr.118 (300), datë 28.01.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër duhet të priset, duke u vendosur pushimi i gjykimit të çështjes.

PËR KËTO ARSYE

Trupi gjykues i Gjykatës së Apelit Shkodër, bazuar në nenin 468 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI

Prishjen e vendimit nr.118 (300), datë 28.01.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe pushimin e gjykimit të çështjes.


Shkodër, më 27.04.2015.

ANËTARE
Lindita HOXHA
d.v

ANËTARE
Valbona VATA
d.v

KRYESUES
Selim KRYEZIU
d.v

Vërtetohet njësia me origjinalin
KANCELARE
Greta LALOSHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR SHKODËR

Nr.Regj.Them. 73/3028(03144)

Nr.Vendimi 118(51-2014-300)

VENDIM

“NE EMER TE REPUBLIKES”

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Shkoder e perbere nga:

HASAN SELIMI - GJYQTAR

Asistuar me sekretare Laura Gjipali, sot me dt. 20.01.2014, mori ne shqyrtim ne séance gjyqesore me dyer te hapura çeshtjen civile qe i perket:

KERKUES: Syri Dervishi, i biri i Nuro dhe Fetije , i datelindjes 01.12.1949 , lindur dhe banues ne Lagjen Naim Gjylbegu, Rr.” B.Bishanaku” .

PALE E TRETE: 1-Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkoder . E perfaqesuar nga juristja Sirjana Bakushi me autorizim.

2-Drejtoria e Pergjitheshme e Tatimeve Tirane .

OBJEKTI: Saktesimin e emrit nga Syrri ne Syri, ne dokumenti zyrtar te rregjistrimit te biznesit si person fizik Syri Dervishi prane Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkoder dhe te sigurime shoqerore per efekt vjeterise e pune .

BAZA LIGJORE : Neni 388 i Kodit te Procedures Civile .

Ne perfundim te gjykimit, gjykata pasi degjoi kerkuesin Syri Dervishi , i cili kerkoi pranimin e kerkeses sipas objektit, perfaqesuesen e pales se trete juristen Sirjana Bakushi , e cila kerkoi rrezimin e kerkeses dhe si shqyrtoi ceshtjen ne teresi .

VEREN

Se kerkuesi Syri Dervishi , i eshte drejtuar Gjykates se Rrethit Gjyqesor Shkoder me kerkese me objekt : Saktesimin e emrit nga Syrri ne Syri, ne dokumenti zyrtar te rregjistrimit te biznesit si person fizik Syri Dervishi prane Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkoder dhe te sigurime shoqerore per efekt vjeterise e pune . Fillimisht kerkuesi ka paraqitur si pale te trete Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkoder, DRSSH Shkoder dhe Bashkia Shkoder . Gjate procesit gjyqesore palet e trete DRSSH Shkoder dhe Bashkia Shkoder kane paraqitur kerkese per perjashtimin e tyre nga ky process gjyqesore pasi nuk

kane ligjitimitet pasiv ne kete kerkese. Gjykata me vendim te ndermjetem I ka perjashtuar nga procesi gjyqesore .

Ne nenin 388 te K.Pr.Civile parashikohet qe: "Kur nga nje fakt varet lindja, ndyshimi oseshuarja e te drejtave personale apo pasurore te nje personi dhe akti qe vertetohet ate eshte zhdukur, ka humbur dhe nuk mund te behet perseri ose nuk mund te merret ne ndonje rruge tjeter, personi i interesuar ka te drejte tekerkoje qe fakti te vertetohet me vendim te gjykates se shkalles se pare."

Nga hetimi gjyqesor rezultoi e provuar se kerkuesi Syri Dervishi ushtron aktivitet provat si person fizik me numer Nipt K46524005R ne emer te Syrri Dervishi . kerkuesi eshte i detyruar per tju drejtuar gjykates, pasi emri i tij figuron gabim Syrri dhe jo ai i sakte Syri. Ai pretendon se kete gabim ne hedhje te te dhenave kompjuterike ne sistem e ka bere pala e trete Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkoder ne rregjistrin e biznesit duke i sjelle atij pasoja . Kerkuesi pretendon se disa here i eshte drejtuar institucioneve te mesiperme dhe akoma nuki i kane dhene zgjidhje problemit te tij. Kerkuesi ka paraqitur me cilesin e pyetes shkresore: QKR e Syrri Dervishi. Vertetim nr. 4827 pro date 24.05.2013 leshuar nga Drejtoriae Pergjithshme e Tatimeve: Vertetim me nr .4860 prot date 25.11.2013 leshuar nga DRSSH Shkoder. Vertetim me nr .prot 10353 date 25.11.2013, Certificate personale date 20.11.2013 leshuar nga ZGJC Bashkia Shkoder. Certificate familjare date 20.11.2013 leshuar nga ZGJC Bashkia Shkoder. Certificate familjare date 14.11.2013 leshuar nga ZGJC Bashkia Shkoder. Vertetim me nota me nr.10 prot date 20.05.2013 leshuar nga Drejtoria Arsimore Rajonhale Shkoder. Fotokopje njesia me origjinalin Libreze Pune date 20.01.1979

Pra nga aktet zyrtare te gjendjes civile kerkuesi rezulton me gjeneralitete te sakte me emrin Syri dhe jo Syrri .

Nga ana e pales se trete ne gjykim juristes Sirjana Bakushin u pretendua se : Me shkresen me nr. 10296/1 prot date 20.12.2013 leshuar nga Drejtoria Rajonale Shkoder me lende dergim informacioni drejtuar Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve Drejtorise se Sherbimit te tatim-paguesve duke i vene ne dijeni subjektin Syri Dervishi per problemin e konstatuar . Me pas kemi printuar faqen e sistemit ne emer te subjektit dhe kemi vene re se ndyshimi ka ndodhur me emrin e sakte Syri Dervishi . Por nga ana e kerkuesit Syri Dervishi eshte pretenduar se ka bere deklarimet elektronik te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore ku emri tregtare I personit te tatueshem perseri eshte shenuar gabim Syrri dhe jo ai /qe pretendon kerkuesi Syri. Kompetenca per te nderhyre ne sistem eshte e Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve deri sot kemi bere verifikimin se cfare eshte bere me problemin e kerkuesit , por del se eshte bere ndryshimi i emrin referuar situates se printuar nga sistemi .

Ne keto kushte, e vetmja menyre per te sakesuar gjeneralitete e kerkuesit , eshte rruga e vertetimit gjyqesor te fakteve me vendim gjykate parashikuar nga neni 388 te Kodit te Procedures Civile.

Neni 388 I Kodit te Procedures Civile parashikon se "kur nga nje fakt varet lindja, ndryshimi ose shuarja e te drejtave personale apo pasurore te nje personi dhe akti qe vertetohet ate eshte zhdukur, ka humbur dhe nuk mund te behet perseri ose nuk mund te merret me

ndonje rruge tjeter, personi I interesuar ka te drejte te kerkoje qe fakti te vertetohet me vendim te gjykates se shkalles se pare...”.

Sa me siper gjykata kerkesa e kerkuesit Syri Dervishi duhet pranuar duke saktësuar emrin ne dokumenti zyrtar te rregjistrimit te biznesit si person fizik prane Drejtorise Rajonale e Tatimeve Shkoder dhe Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve Tirane nga ai I shenuar gabim “Syrrri” ne ate te sakte “Syri”.

PER KETO ARSYE

Gjykata, bazuar ne nenet 126, 306 e 388 te K. Pr. Civile

VENDOSI

1. Pranimin e kerkese, kerkuesit Syri Nuro Dervishi, duke saktësuar emrin ne dokumenti zyrtar te rregjistrimit te biznesit si person fizik prane Drejtorise Rajonale e Tatimeve Shkoder dhe Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve Tirane nga ai I shenuar gabim “Syrrri” ne ate te sakte “Syri”.
2. Shpenzimet gjyqesore sic jane bere
3. Kunder ketij vendimi lejohet ankim brenda 15 diteve ne Gjykatën e Apelit Shkoder .Pe r palen e trete ne mungese Drejtoria e Pergjithshme te Tatimeve Tirane , ky afat fillon nga dita e marrjes dijeni te ketij vendimi .

U shpall sot ne Shkoder date 28.01.2014, ora 09.55.

Sekretare
Laura Gjipali

Gjyqtar
Hasan Selimi

Shenim: Kunder ketij vendimi ka paraqitur ankim personi i trete Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkoder ne Gjykatën e Apelit Shkoder e cila me vendimin **nr. 258 date 27.04.2015,**

Ka vendosur:

-Prishjen e vendimit me Nr 118(300) date 28.01.2014 te Gjykates se Rrethit Gjyqsor Shkoder dhe pushimin e gjykimit te ceshtjes.

KRYESEKRETAR
Mirsad Isufi

KANCELAR
Artan Dragoni